



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 137

Ora: 15:35

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 75, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 22.05.2023
NGA PARTIA "ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Petrit Dedaj

OBJEKT:

1. Kundërshtim i vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Përmet Kamëz.
2. Rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit për këshillin bashkiak Kamëz.
3. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për këshillin e bashkisë Kamëz.



BAZË LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 75 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 24.05.2023, ora 15:35, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht në ankim nuk është referuar vendimi që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor, në përputhje me të cilën duhet saktësuar objekti i kërkesës ankimore.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 126, të K.Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 75, datë 22.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 25.05.2023, ora 16:00.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraprak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 24.05.2023.

Elvin	LAKO	- Relator
Elvis	ÇEFA	- Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	- Anëtar
Ledio	BRAHO	- Anëtar